

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE – ALPEX SH.A.**VENDIM TEKNIK Nr. 5-T****“Ndërfaqja për Programimin e Aplikacioneve të ETSS (API)”**

Duke marrë në konsideratë dispozitat e paragrafit F.4.3.6 në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike-Kushtet e Përgjithshme dhe paragrafit G.1.2.1 (d) në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike-Procedurat e Tregtimit të Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX sh.a (në vijim referuar si “ALPEX”), siç janë në fuqi:

ALPEX SH.A miratoi:

1. Vendimin Teknik- Ndërfaqja për Programimin e Aplikacioneve të ETSS (API).
2. Ky Vendim Teknik Nr.5-T i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë – ERE dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji – ZRrE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATORI I ALPEX SH.A**Sokol Dishnica**

Neni 1

Objekti-Fushëveprimi-Përkufizimet

1. Objektivi i këtij Vendimi është aksesimi për Anëtarët e Bursës (në vijim **“Përdoruesi”**) në Ndërfaqen e Programimit të Aplikacionit (në vijim **“API”** ose **“API ETSS i ALPEX-it”**) për lidhjen e sistemit të tyre me Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS) si dhe përcaktimi i Kushteve të Përdorimit (në vijim **“Kushtet e Përdorimit”**) të cilat duhet të zbatohen për përdorimin e API-t ETSS të ALPEX-it nga Përdoruesit, si dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse.
2. Çdo Përdorues që dëshiron të përdorë API-n i nënshtrohet Kushteve të Përdorimit dhe lidh Marrëveshjen përkatëse për Përdoruesit e API-t (në vijim **“Marrëveshja”**). Për qëllime të pranimit të Kushteve të Përdorimit, Përdoruesi duhet të nënshkruajë Formularin TR-1-F4 “Formulari i Lidhjes me Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS)” dhe në të duhet të përzgjedhë Opsionin 2 [ETSS API]. Duke përzgjedhur këtë opsion, çdo Përdorues deklaron se ka kuptuar dhe pranuar të gjithë informacionin ligjor që përmbajnë Kushtet e Përdorimit dhe i pranon ato në tërësinë e tyre. Kushtet e Përdorimit, siç janë në fuqi, së bashku me formularin e nënshkruar TR-1-F4 “Formulari i Lidhjes me Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS)” do të përbëjnë “Marrëveshjen për Përdoruesit e API”.
3. Përkufizimet e këtij Vendimi Teknik kanë të njëjtin kuptim si ato të parashikuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

Neni 2

Regjistrimi dhe Aksesimi në API-n e ETSS

1. Çdo Përdorues i cili ka interes për API-n, duhet të hyjë në faqen e internetit të ALPEX-it (www.alpex.al) për të shkarkuar dhe plotësuar Formularin e Aplikimit (Formulari TR-1-F4 “Lidhja me Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS)”) dhe ta paraqesë pranë ALPEX për marrjen e këtij aksesimi.
2. Në Formularin e Aplikimit duhet të plotësohet informacioni i përditësuar, duke përfshirë emrin tregtar të kompanisë, Kodin EIC, emrin e plotë të përdoruesit, numrin e celularit të përdoruesit dhe adresën e email-it të përdoruesit.
3. ALPEX do të dërgojë link-et përkatëse për aksesimin në “ETSS API” tek përdoruesi, në adresën e tij të email-it siç është plotësuar në Formularin e Aplikimit. ALPEX rezervon të drejtën për të kontaktuar përdoruesin e caktuar për çështje që lidhen me API-n e ETSS gjatë orarit të punës dhe/ose në mënyrë të arsyeshme.

Neni 3

Specifikimet Teknike të API të ETSS, Kredencialet dhe Zhvillimi i Sistemit

1. API i ETSS përmban Specifikimet Teknik e tij së bashku me dokumentacionin përkatës.
2. Specifikimet Teknike të API të ETSS ofrohet "siç është" dhe "siç është i disponueshëm" pa asnjë lloj garancie, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar.

3. Çdo Përdorues duhet të zhvillojë ose të sigurojë një sistem në përputhje me specifikimet teknike të ofruara të API të ETSS të ofruara nga ALPEX.
4. Kredencialet, duke përfshirë çelësat e sigurisë, kodin e autentifikimit (token), informacionin e aksesimit dhe informacionin teknik përkatës, ofrohen vetëm nga ALPEX për Përdoruesit nëpërmjet adresave të email-it të autorizuar dhe të dhëna në Formularin TR-1-F4.
5. Kredencialet e dhëna nga ALPEX për Përdoruesin janë konfidenciale dhe nuk duhet të shiten, ndahen, transferohen apo të jepen në nënlicencë tek asnjë Përdorues tjetër. Të gjitha aktivitetet që kryhen duke përdorur Kredencialet janë përgjegjësi e Përdoruesit.

Neni 4

Testimi dhe aksesimi në ETSS

1. Sapo Përdoruesi të ketë përfunduar zhvillimin e nevojshëm të sistemit në përputhje me specifikimet teknike të API dhe përpara se të hyjë në mjedisin real të platformës, Përdoruesi duhet të kontaktojë ALPEX-in për të mundësuar një lidhje me mjedisin e testimit ETSS për kryerjen e testeve të sistemit të tij.
2. Testet e Sistemit të Përdoruesit mbulojnë të gjitha funksionalitetet e sistemit të tij dhe vërtetojnë se sistemi i Përdoruesit nuk ka efekt të dëmshëm në ETSS-në e ALPEX-it.
3. Përdoruesi duhet të sigurojë që:
 - a) çdo person që vepron në emër të tij ka autorizimin e nevojshëm për të përdorur API-n.
 - b) çdo sistem që përdoret për të hyrë në API duhet të jetë i konfiguruar siç duhet për t'u lidhur në mënyrë të sigurt me API-n (siç mund të ndryshohet herë pas here).
 - c) çdo kredencial hyrjeje i ofruar nga ALPEX për përdorimin e API-t duhet të mbahet konfidencial dhe i sigurt. Përdoruesi është rreptësisht përgjegjës për të gjithë përdorimin e çdo kredenciali të regjistruar deri në revokimin e tyre nga ALPEX, pas kërkesës së një personi të autorizuar nga Përdoruesi.
 - d) çdo Urdhërporosi e vendosur përmes API-t nuk është e gabuara.
 - e) nuk duhet të transmetojë viruse ose programe të tjera kompjuterike që mund të dëmtojnë, ndërhyjë në mënyrë të dëmshme, të ndërpresë fshehurazi ose të përvetësojë ETSS-në dhe përmbajtjen e saj.

Neni 5

Përgjegjësitë dhe Kufizimet e Përdoruesit

1. Përdoruesi është ekskluzivisht përgjegjës për:
 - a) sigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të komunikimit të tij, duke përfshirë kompjuterët dhe modemet e nevojshme për aksesin në API.
 - b) disponueshmërinë, aksesin, cilësinë e transmetimit dhe funksionalitetin e çdo linje telekomunikimi, sistemi kompjuterik ose softueri që nevojitet për akses dhe përdorim të API-t.
 - c) korrektësinë, saktësinë dhe formatin e të dhënave të tij (përveç kur ALPEX është ofruesi i të dhënave) dhe të çdo përmbajtjeje tjetër të nevojshme për funksionimin e API-t, sipas kërkesave të Specifikimeve Teknike të API të ETSS.

- d) çdo autorizim, licencë, marrëveshje ose dokumentacion tjetër ligjor midis Përdoruesit dhe palëve të treta që kërkojnë për përdorimin e API-t nga Përdoruesi. Lidhur me këtë dispozitë, Anëtar i Bursës është përgjegjës ekskluzivisht për sigurimin e çdo të drejte, licence dhe miratimin nga palët e treta.
2. Çdo Përdorues merr përsipër detyrimin të mos zhvillojë aplikacione që:
- a) janë mashtruese ose keqinformuese.
 - b) shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale ose të drejtat e publikimit ose privatësisë të çdo Përdoruesi të tretë.
 - c) kanë tendencë shpifëse, kërcënuese ose ngacmuese.
 - d) përmbajnë virus ose programe kompjuterike që mund të dëmtojnë, të ndërhyjnë në mënyrë të dëmshme, të ndërpresin fshehurazi ose të përvetësojnë çdo sistem ose të dhënë, ose
 - e) të shkelë në ndonjë Ligj në fuqi.
 - f) të zbulojë ose t'iu japë API-n e ETSS ose Kredencialet e aksesit çdo personi ose entiteti tjetër përveç punonjësve përgjegjës të Përdoruesit dhe çdo kontraktori që vepron në emër të tij dhe është autorizuar siç duhet për ta bërë këtë dhe është njohur me API-n ETSS para përdorimit, si dhe çdo ndryshimi të mëvonshëm në të.
3. Çdo Përdorues është përgjegjës të mos përdorë API-n e ETSS për qëllime të paligjshme, ose në ndonjë mënyrë që shkel Kushtet e Përdorimit, apo shkel ndonjë ligj apo rregullore për privatësinë ose mbrojtjen e të dhënave, apo shkel të drejtat e palëve të treta ose ekspozon ALPEX-in ndaj përgjegjësisë ligjore.
4. Çdo Përdorues është përgjegjës të mos kopjojë, përshtatë, riformatojë, dekompijojë, shkatërrojë, dekodojë, modifikojë API-n e ETSS, kredencialet e aksesit të të dhënave ose informacion tjetër, me çfarëdo lloji mjeti dhe formë.
5. Të drejtat dhe detyrimet shtesë që zbatohen për Përdoruesin mund të specifikohen ose shtohen herë pas here vetëm nga ALPEX.

Neni 6

Përgjegjësitë e ALPEX

1. ALPEX nuk do të jetë përgjegjës për:
- a) çdo ndërprerje, pezullim ose padisponueshmëri të përkohshme në aksesin ose funksionimin e API-t, përveç në rast se kjo është rezultat i neglizhencës së rëndë ose sjelljes së qëllimshme të ALPEX-it.
 - b) çdo humbje ose dëmtim për Përdoruesin si rezultat i aksesit në informacion nga faqja e internetit e ALPEX-it ose nga përdorimi i API-t, duke përfshirë gabime nga pasaktësitë teknike, pasaktësitë ose përmbajtjen jo të plotë të të dhënave, viruset ose materiale të tjera të dëmshme.
 - c) çdo humbje ose dëmtim si rezultat i mosfunksionimit, paqëndrueshmërisë ose paaksesueshmërisë së API-t, pajisjeve ose shërbimeve të ofruara nga palët e treta ose rrethana të tjera për të cilat ALPEX nuk është përgjegjës, duke përfshirë Forcën Madhore.

- d) humbjen e konfidencialitetit, sigurisë ose besueshmërisë së lidhjes së sistemit të Përdoruesit me API-n.
2. Në rast se Përdoruesi beson në mënyrë të arsyeshme se ka gabime në API, ai duhet ta njoftojë ALPEX-in menjëherë me shkrim përmes adresave të email-eve të autorizuara, dhe ALPEX do të bëjë përpjekjet më të mira për të korrigjuar gabime të tilla brenda një kohe të arsyeshme nga marrja e një njoftimi të tillë.

Neni 7

Licenca e API-t

1. ALPEX i jep Përdoruesit një të drejtë dhe licencë jo-ekskluzive, jo të transferueshme, pa mundësi nën licencimi, në nivel mbarë botëror dhe të revokueshme sipas të drejtave të pronësisë intelektuale të ALPEX-it dhe Ofruesit të Shërbimit të ALPEX-it për të:
- a) zhvilluar, testuar, operuar dhe mbështetur një sistem.
 - b) përdorur API-n sipas nevojës për të dërguar dhe transmetuar të dhëna në masën e nevojshme për të ndërveprues me ETSS.
 - c) shpërndarë ose lejuar akses në integrimin e API-t në çdo sistem për përdoruesit fundorë, dhe
 - d) shfaqur përmbajtjen e aksesuar përmes API-t brenda sistemit.

Neni 8

Ndryshimet dhe Mirëmbajtja e API-t

1. API do të jetë subjekt i përditësimeve të versioneve. ALPEX rezervon të drejtën për të ndryshuar API-n herë pas here dhe do të përpiqet t'iu ofrojë Përdoruesve çdo version të ri nëpërmjet një njoftimi të arsyeshëm për këto ndryshime përmes faqes së internetit të ALPEX-it.
2. Pas çdo ndryshimi në versionin e fundit të API-t, ALPEX ka të drejtë të ndalojë mbështetjen e versioneve më të vjetra të API-t. ALPEX do të bëjë përpjekjet më të mira për të siguruar që versionet më të vjetra të API-t të mbeten funksionale, por nuk garanton ose jep garanci se kjo do të jetë e mundur.
3. Në rast mirëmbajtje, ALPEX do ta kryejë atë jashtë orarit të tregtimit kur është e mundur, dhe do të japë një njoftim paraprak për çdo mirëmbajtje të planifikuar të sistemit që mund të ndikojë në API përmes çdo mjeti të disponueshëm, duke përfshirë publikimet/njoftimet në faqen e internetit.

Neni 9

Monitorimi i Përdorimit të API-t

1. Duke përdorur API-n, Përdoruesi pranon dhe bie dakord që ALPEX, përmes personelit të autorizuar dhe Ofruesit të Shërbimit të tij, do të ketë të drejtën të monitorojë përdorimin e API-t nga Përdoruesi, për të siguruar që API përdoret në një mënyrë të përshtatshme. Përdoruesi nuk ka të drejtë të bllokojë ose të kufizojë monitorimin.

2. ALPEX rezervon të drejtën të ndërmarrë veprime që janë të nevojshme në mënyrë të arsyeshme për të siguruar që performanca e ETSS-së së ALPEX-it të mos ndikohet nga përdorimi i API-t nga Përdoruesi. ALPEX rezervon të drejtën të refuzojë përdorimin e API-t për sistemin e një Pale që mund të rrezikojë stabilitetin e ETSS-it ose që nuk përputhet me API e ETSS të ALPEX-it dhe me Kushtet e Përdorimit.
3. Në rast të ndonjë keqpërdorimi që ndikon Palët e tjera ose shkakton një kërcënim sigurie për ALPEX-in ose pjesëmarrësit e tjerë të tregut, ALPEX rezervon të drejtën të:
 - a) shkëpusë Përdoruesin nga API.
 - b) kufizojë aksesin e Përdoruesit në API.
 - c) pezullojë Përdoruesin nga përdorimi i API-t.
 - d) revokojë një ose më shumë nga kredencialet dhe token-et e hyrjes së Përdoruesit, përkohësisht ose përgjithmonë.
4. ALPEX do ta informojë Përdoruesin për një ndërprerje dhe/ose pezullim të tillë sa më shpejtë të jetë e mundur.
5. Veprimet e përshkruara në pikën 3 do të ndërmerren në rast të mos-përputhshmërisë me:
 - a) Kushtet e Përdorimit si dhe
 - b) rasteve të mëposhtme:
 - i. Transferimi, shitja ose publikimi në çfarëdo lloj forme e çdo të dhëne të vënë në dispozicion të Përdoruesit përmes API-t.
 - ii. Përdorimi i papërshtatshëm i API-t.
 - iii. Çdo shkelje e të drejtave të pronësisë intelektuale të ALPEX-it në lidhje me API-n.
 - iv. Përdorimi i paautorizuar i çdo kredenciali hyrjeje.
 - v. Përdorimi i papërshtatshëm i kërkesave për të dhëna me një normë që konsiderohet të jetë përtej asaj që është e pranueshme (siç përcaktohet nga ALPEX sipas gjykimit absolut të tij).
 - vi. Çdo shkelje e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike të ALPEX-it ose çdo ligji në fuqi.

Neni 10

Forca Madhore

1. As ALPEX dhe asnjë Përdorues nuk do të jenë përgjegjës në rast të ngjarjeve të forcës madhore që i pengojnë ata të përmbushin detyrimet e tyre përkatëse sipas Kushteve të Përdorimit.
2. ALPEX ose/dhe çdo Përdorues që bëhet i vetëdijshëm për një Ngjarje të Forcës Madhore që shkakton, ose që ka të ngjarë të shkaktojë ndonjë dështim ose vonesë në kryerjen nga Pala tjetër të ndonjë detyrimi sipas Kushteve të Përdorimit, duhet:
 - a) të njoftojë menjëherë Palën tjetër.
 - b) të informojë Palën tjetër për periudhën për të cilën vlerësohet se një dështim ose vonesë e tillë do të vazhdojë.
3. Pala e prekur nga ngjarja e Forcës Madhore do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të zbutur efektet dhe për të përmbushur detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Kufizimi i përgjegjësisë

1. ALPEX nuk do të jetë përgjegjës ndaj një Përdoruesi për asnjë humbje, përfshirë fitimin e munguar apo të ardhurat, as për ndonjë dëm indirekt, të veçantë, të rastësishëm, pasues, mbulues apo ndëshkues, pavarësisht shkakut, qoftë ai kontraktor, jashtëkontraktor apo i bazuar në ndonjë teori tjetër të përgjegjësisë, që rrjedh nga shkelja e detyrimeve sipas këtyre Kushteve të Përdorimit. Përgjegjësia e ALPEX do të përjashtohet në të gjitha rastet sipas këtyre Kushteve të Përdorimit, përveç rasteve kur ndonjë humbje ose dëm i shkaktuar Përdoruesit është pasojë e pakujdesisë së rëndë ose veprimit të qëllimshëm të ALPEX.
2. Çdo Përdorues përdor API-n, përmbajtjen dhe të dhënat e disponueshme me rreziqet e veta dhe nën përgjegjësinë e vet.
3. Përdoruesi do të dëmshpërblejë dhe mbajë të padëmtuar ALPEX-in, drejtorët, punonjësit dhe ofruesit e shërbimit të tij nga dhe kundër çdo pretendimi, humbjeje, sanksioni rregullator, dëm apo kosto që rrjedh nga keqpërdorimi i API-t, shkelja e detyrimeve të konfidencialitetit ose incidenti i sigurisë kibernetike që buron nga sistemet e Përdoruesit.

Neni 12

Konfidencialiteti

Çdo Përdorues pranon se mund të marrë informacion konfidencial ose me karakter pronësor i cili ose identifikohet si konfidencial në kohën e zbulimit ose duhet të njihet në mënyrë të arsyeshme nga ALPEX si konfidencial në varësi të rrethanave, pavarësisht nëse është shënuar si konfidencial ose me karakter pronësor. Për të shmangur çdo dyshim, API-t ETSS, dokumentacioni teknik i API-t të ETSS dhe Marrëveshja e Përdoruesit të API-t konsiderohen si Informacion Konfidencial i ALPEX-it. Informacioni Konfidencial nuk duhet të përfshijë asnjë informacion që Përdoruesi mund të përcaktojë se ka qenë përgjithësisht i disponueshëm për publikun (ose bëhet i tillë) pa fajin ose neglizhencën e ALPEX-it, dhe është përfituar në mënyrë të ligjshme nga Përdoruesi apo nga një Përdorues i tretë pa detyrim konfidencialiteti. Detyrimi i konfidencialitetit nuk do ta pengojë ALPEX-in të zbulojë çdo informacion tek çdo person ose kontraktor i angazhuar nga ALPEX në kryerjen e shërbimeve në lidhje me API-n, me kusht që një person i tillë të jetë subjekt i një detyrimi të përshtatshëm konfidencialiteti.

Neni 13

Kostot dhe Tarifat

1. Lidhja e çdo sistemi të Përdoruesit me ETSS është subjekt i Listës së Tarifave të ALPEX. ALPEX ka të drejtë të rregullojë tarifat përkatëse herë pas here me një njoftim të arsyeshëm në kohë përmes Faqes së saj të Internetit.
2. Pasi Përdoruesit i mundësohet lidhja API-t, mbështetja e ofruar më pas nga ALPEX do të jetë pa pagesë.
3. Çdo Përdorues është përgjegjës për mbulimin e kostove dhe shpenzimeve të veta në mënyrë që të përmbushë detyrimet e tij sipas Kushteve të Përdorimit.

Neni 14

Marrëveshja e Plotë – API, Njoftimet dhe Ndashmëria

1. Dokumentet që formojnë marrëveshjen janë reciprokisht shpjeguese të njëra-tjetrës. Dokumentet e përmendura në këtë nen përmbajnë të gjithë marrëveshjen midis ALPEX dhe çdo Anëtarit të Bursës në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje dhe Dokumenteve. Pjesët përbërëse të kësaj Marrëveshjeje të cilave Palët u referohen gjatë zbatimit të saj janë:
 - a) Këto Kushte Përdorimi (që përfaqësohen me nënshkrimin e pikës së mëposhtme).
 - b) Formulari i nënshkruar TR-1-F4 "Formulari i Lidhjes me Sistemin e Tregtimit të Energjisë në Çast (ETSS)" siç mund të përfitësohet herë pas here nga ALPEX dhe t'u komunikohet Anëtarëve të Bursës përmes faqes zyrtare të ALPEX.
 - c) Specifikimi Teknik i API i ETSS me dokumentacionin përkatës.
2. Çdo njoftim duhet të jepet me shkrim nga Palët ose përfaqësuesit e autorizuar të Palëve përfaqësuesve të autorizuar të ALPEX-it.
3. Në rast se një ose më shumë dispozita të kësaj marrëveshjeje (siç specifikohet më sipër) për ndonjë arsye konsiderohen të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme, dispozitat e mbetura do të jenë të vlefshme dhe të zbatueshme.

Neni 15

Komunikimet

1. Për pyetje ose çdo çështje që lidhet me API-n sipas këtyre Kushteve të Përdorimit, çdo Përdorues mund të kontaktojë si më poshtë:
 - a) përmes email në: trade@alpex.al
 - b) duke krijuar një kërkesë (ticket) përmes sistemit të ticketing-ut të ALPEX, (Subjekti i email-it duhet të fillojë me [ALPEX ETSS API])
2. Përdoruesi i caktuar në Formularin e Aplikimit TR-1-F4 është i autorizuar të përfaqësojë Përdoruesin në të gjitha dhe çdo çështje sipas Kushteve të Përdorimit. Përdoruesi siguron që të gjitha informacionet e kontaktit janë të përditësuara dhe të sakta dhe mund të ndryshojë në çdo kohë të dhënat e veta, duke përfshirë përdoruesit e emëruar, duke dërguar një email në adresat e email-it të ALPEX të specifikuara më sipër dhe Formularin TR-1-F4 të përditësuar.

Neni 16

Përditësimet dhe Ndryshimet e Kushteve të Përdorimit

ALPEX sipas gjykimit të tij, mund të përditësojë ose modifikojë Kushtet e Përdorimit në mënyrë të njëanshme në çdo kohë. Ndryshime të tilla do të publikohen në faqen e internetit të ALPEX të paktën njëzet (20) ditë para ditës kur versioni i ndryshuar hyn në fuqi. Çdo Përdorues konsiderohet se i ka pranuar ndryshimet përmes përdorimit të vazhdueshëm të API ETSS me efekt nga data në të cilën versioni i ndryshuar i Kushteve të Përdorimit hyn në fuqi.

Neni 17

Marrëveshja

1. Të gjitha Palët kuptojnë se asnjë marrëdhënie shoqërimi, përfaqësimi ose themelimi i një entiteti të ri ligjor nëpërmjet këtyre Kushteve të Përdorimit nuk krijohet ndërmjet ALPEX-it dhe asnjë Përdoruesi në asnjë mënyrë.
2. Këto Kushte Përdorimi përcaktojnë të gjitha kushtet që janë rënë dakord midis ALPEX dhe Përdoruesit në lidhje me temat e mbuluara prej tyre dhe zëvendësojnë të gjitha dhe çdo marrëveshje të mëparshme që lidhet me API-n.

Neni 18

Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Këto Kushte Përdorimi dhe Marrëveshja përkatëse e Përdoruesit të API-t rregullohen dhe interpretohen në përputhje me ligjet e Shqipërisë dhe të Kosovës. Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje që mund të lindë midis ALPEX dhe Përdoruesit për shkak të ose në lidhje me këto Kushte Përdorimi dhe Marrëveshjen përkatëse të Përdoruesit të API-t, palët duhet së pari të përpiqen me zgjidhje miqësore. Në rast të moszgjidhjes së mosmarrëveshjes me zgjidhje miqësore, mosmarrëveshja do t'i referohet gjykatave kompetente të Tiranës/Prishtinës, të cilat kanë juridiksion përfundimtar për të zgjidhur çdo pretendim, mosmarrëveshje ose ndryshim që mund të lindë nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo çështje në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose përfundimin e saj.
2. Secila Palë heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose në të ardhmen lidhur me zgjedhjen e vendit të gjykimit në Tiranë/Prishtinë dhe çdo pretendim se procedura e tillë është ngritur në një gjykatë të papërshtatshme, dhe gjithashtu pranon në mënyrë të parevokueshme që një vendim gjyqësor në çdo procedurë të ngritur në gjykatat e Tiranës/Prishtinës do të jetë përfundimtar dhe detyrues për atë Palë dhe mund të zbatohet në gjykatat e çdo juridiksioni tjetër në përputhje me ligjin e atij juridiksioni.

Neni 19

Dispozita Përfundimtare

1. ALPEX mund ta përfundojë Marrëveshjen për Përdoruesit e API-t dhe të pezullojë aksesin në API menjëherë, pa përgjegjësi ose detyrim tjetër, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Përdoruesit, në rast se Përdoruesi shkel ndonjë nga termat ose kushtet e këtyre Kushteve të Përdorimit.
2. Përdoruesi mund ta përfundojë Marrëveshjen për Përdoruesit e API-t duke dhënë një njoftim me shkrim jo më pak se tridhjetë (30) ditë më parë, ku në skadimin e periudhës së njoftimit, i gjithë aksesin në API do të ndërpritet.
3. Të gjitha dispozitat e Kushteve të Përdorimit të cilat nga natyra e tyre duhet të mbeten në fuqi pas përfundimit do të mbeten në fuqi pas përfundimit, duke përfshirë, pa kufizim, dispozitat mbi pronësinë, përjashtimet nga garancitë dhe kufizimet e

përgjegjësisë. Përfundimi i aksesit dhe përdorimit të API-t nga Përdoruesi nuk do ta lirojë Përdoruesin nga asnjë detyrim që lind ose krijohet para një përfundimi të tillë dhe nuk do të kufizojë ndonjë përgjegjësi që Përdoruesi mund të ketë ndaj ALPEX.

4. Në çdo rast, nëse ndërprerja shkaktohet për shkak të shkeljes së kësaj Marrëveshjeje dhe të dispozitave të API, pala shkelëse do të jetë përgjegjëse për kompensimin e dëmeve të shkaktuara palës tjetër, në përputhje me dhe brenda kufizimeve të përcaktuara në API.

Neni 20

Hyrja ne fuqi

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi më datë 20.03.2026.

Ky Vendim Teknik publikohet në faqen zyrtare të internetit të ALPEX www.alpex.al